



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.297/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Petrit Kryeziu, jurist e diplomuar, paraqitur kundër Astrit Bujupaj, Kryesues i KVV, për shkak të asistimit në votim, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur në prani të përfaqësuesit të parashtruesit të ankesës dhe të palës në procedurë, me datë 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, Anr.297/2017, e datës 12.06.2017, paraqitur kundër Astrit Bujupaj, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 1913E/01R, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesë si në ankesën e paraqitur me datë 12.06.2017, ashtu edhe në seancën e mbajtur me datë 13.06.2017, ka pretenduar se gjatë ditës së votimit monitoruesi i tyre ka vërejtur parregullsi në qendrën e votimit në Fakultetin Juridik/Ekonomik, në sallën 1913E/01R, ku në kabinën e votimit kanë qenë prezent më shumë se një person dhe se një të moshuar e kanë asistuar dy persona, ku njëri ka asistuar dhe tjetri u sigurua për votën duke shikuar anash. Parashtruesi në ankesës po ashtu në seancën dëgjimore të datës 13.06.2017, mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore, duke theksuar ka kontaktuar me vëzhguesen e BIRN Amire Qamili, e cila ka qenë prezentë në qendrën e votimit dhe se e njëjta ka mbetur pranë qëndrimit se ka ekzistuar shkelja dhe ka theksuar se kryesuesi i vendvotimit ka intervenuar që të largohet personi i tretë i cili ka qenë me ID, por nuk e din se me çfarë shenje të identifikimit, por kjo shkelje nuk e din a është evidentuar.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 13.06.2017, Astrit Bujupaj, në cilësinë e palës ka deklaruar se është e vërtet se ka ardhur për të votuar një person i moshuar i cili shihet edhe në foto dhe e kam pyetur nëse mund të ju ndihmoj, ai është deklaruar se duhet ti asistoj dikush për të votuar, pas tij ka qenë personi në foto të cilin nuk kam mundur ta identifikoj dhe i njëjti është deklaruar se ai do ti ndihmoj, të njëjtin e kam pyetur nëse i ka asistuar dikujt tjetër për votim dhe është përgjigjur se po, i kam thënë se nuk mund të asistoj dhe sipas rregullave kam kërkuar një person tjetër nga radha e votuesve duke pritur ndërsa personit të tretë i kam kërkuar që të largohet, i njëjti është larguar nga salla e votimit, pastaj unë jam ulur në tavolinën time për të mbajtur shënim lidhur me votimin me asistencë, në ndërkohë e kam parë

që personi që më herët kishte kërkuar që ti asistoj i është ofruar nga mbrapa personit të moshuar që votonte, menjëherë jam ngritur nga tavolina dhe kam kërkuar nga i njëjti që të largohet, në momentin kur kam shkuar i moshuari e kishte kryer votimin dhe ishte duke e palosur fletëvotimin, jam ofruar deri afër për të kërkuar nga personi që të largohet por nuk ka dal në anën tjetër të vendvotimit pasi kjo nuk me lejohet dhe se pasi ka mbaruar votimi kam marr shënimet mbi votuesin me asistencë në ndërkohë ka ardhur vëzhguesja e BIRN dhe më ka thënë se kjo nuk është në rregull, unë e kam pranuar që ajo çfarë ka bërë personi i tretë nuk është në rregull por unë i kam ndërmarr të gjitha veprimet për ta mënjanuar shkeljen dhe se personi i tretë ka pasur një begj në qafë i njëjti ka qenë i vendosur mbrapsht dhe nuk kam mundur ta identifikoj, por për të njëjtin nuk kam mbajtur as shënim.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimi të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë, dhe provat si në vijim: shikoj tri fotografi në kopje në formatin A4, bardh e zi.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pohimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, paneli vlerësoi, një person i moshuar duke votuar me asistim nga një person tjetër i cili gjendet afër tij, e po ashtu dhe një person i tretë i cili shikon nga afër rrjedhën e votimit. Personi i tret në foto është Kryesuesi i Vendvotimit Astrit Bujupaj, i cili gjatë votimit me asistencë gjendet afër kabinës së votimit, mirëpo nga e njëjta foto nuk mund të vërtetohen pretendimet ankimore.

Paneli, me rastin e vendosjes mori parasysht deklaratën e përfaqësuesit të parashtruesit të ankesës, si dhe deklaratën e Kryerësit të Supozuar- Kryesuesit të Vendvotimit 1913E/01R, Astrit Bujupaj, të cilat deklarata përputhen me faktin se Kryesuesi i Vendvotimit, ka reaguar kur ka vërejtur parregullsitë dhe i ka marr masat e nevojshme konform nenit 74 par.10 të LZP-së, për të siguruar integritetin sigurinë dhe qetësinë në procesin e votimit, Vendvotimin 1913E/01R, pasi i njëjti kishte marr masa lidhur largimin e personit të tretë i cili kishte asistuar edhe me herët në votim, si dhe ka reaguar kur ka vërejtur parregullsitë, kur personi i tret nga fotoja ka hyr përsëri vjedhurazi të kabina e votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke u bazuar nenin 74 par.10 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 297/2017 më datën 13.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme, në afat prej 24 orëve nga momenti i pranimit të njëjtit.